



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:274742  
Datë: 26.03.2025  
Numri i dokumentit: 07049350

C.nr.2816/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. M. nga Fusha e P. të cilin e përfaqëson Qazim Muriqi nga fusha e P. Rr. e V., kundër të paditurës V.K. nga P. të cilën e përfaqëson Selim Berisha avokat në Pejë, baza juridike: vërtetim pronësie, vlera e borxhit 5,000 euro, me dt.26.03.2025 mori dhe përpiloi këtë:

AKTVENDIM

- I. KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit B. M. nga Fusha e P., kundër të paditurës V.K. nga P., baza juridike: vërtetim pronësie, vlera e borxhit 5,000 euro, në këtë çështje kontestimore e udhëhequr me numër të lëndës C.nr.2816/21.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësi B. M. nga Fusha e P. të cilin e përfaqëson Qazim Muriqi nga fusha e P. Rr. e V., kundër të paditurës V.K. nga P. të cilën e përfaqëson Selim Berisha avokat në Pejë, ka ngritur padi nga baza juridike: vërtetim pronësie, vlera e borxhit 5,000 euro.

Me datën 26.03.2025, gjykata ka caktuar seancën kryesore në të cilën nuk ka prezantuar i autorizuari i palës paditëse, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt ku për seancë është njoftuar sipas procesverbalit të datës 03.03.2025 në të cilën seancë ka qenë prezent dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Po ashtu, nuk ka prezantuar as pala e paditur, edhe pse i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt ku për seancë

është njoftuar sipas procesverbalit të datës 03.03.2025 në të cilën seancë ka qenë prezent dhe mungesën nuk e ka arsyetuar

Në bazë të nenit 423.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*. Me këtë rast gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për të vepruar sipas kësaj dispozite, ngase pala paditëse nuk ka prezantuar në seancë e po ashtu edhe i padituri i cili me mospjesmarrjen e tij në seancë përkundër që është ftuar në mënyrë të rregullt, ka lëshuar mundësinë lidhur me prapësimet ose propozimet procedurale.

Lidhur me shpenzimet e procederues kontestimore, gjykata ka vendosë duke u bazuar në nenin 450 dhe 463 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 423.3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:274742, C.nr.2816/21, 26.03.2025**

Gj y q t a r i:  
Vegim Maloku

---

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.